

RELACION

PËR

PROJEKTVENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.173, DATË 24.3.2023, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E STRATEGJISË KOMBËTARE TË PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE 2023–2030, PLANIT TË VEPRIMIT PËR ZBATIMIN E SAJ, SI DHE PLANIT TË ZBATIMIT TË GARANCISË RINORE 2023–2024””, I NDRYSHUAR

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Me anë të këtij projektvendimi realizohet miratimi i Planit të Zbatimit të Garancisë Rinore për periudhën 2026–2028, pas mbarimit të afatit të planit të mëparshëm.

Dokumenti i Politikave Prioritare për periudhën 2026–2028, miratuar me VKM nr. 91, datë 12.02.2025, si dhe Strategjia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive 2023–2030, miratuar me VKM nr. 173, datë 24.03.2023, vendosin theks të veçantë në përfshirjen e të rinjve në tregun e punës dhe në zhvillimin cilësor të forcës së punës, përmes zbatimit të programit të Garancisë Rinore. Ky program zbatohet në përputhje me vizionin dhe direktivat e Bashkimit Evropian, si dhe me kërkesat që burojnë nga procesi i integritimit të Shqipërisë në BE, me synimin që deri në vitin 2030 vendi të ketë një ekonomi konkurruese dhe një shoqëri gjithëpërfshirëse, e mbështetur në parimin: “Punësim cilësor dhe aftësim gjatë gjithë jetës për të gjithë”, me fokus të veçantë tek të rinjtë.

Garancia Rinore synon integrimin në tregun e punës të të rinjve të grupmoshës 15–29 vjeç që nuk janë në arsim, punësim apo formim profesional (NEET), përmes mbështetjes së të rinjve të papunë të regjistruar në zyrat e punës, duke u

ofruar atyre një ofertë punësimi, formimi profesional ose arsimimi brenda një periudhe katër (4) mujore nga momenti i regjistrimit.

Për të orientuar kuadrin politik dhe zbatimin e masave për pilotimin e programit të Garancisë Rinore në Shqipëri gjatë periudhës 2023–2024, në mars 2023 u miratua Plani i Zbatimit të Garancisë Rinore 2023–2024, si pjesë e Strategjisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive, me Vendimin nr. 173 të Këshillit të Ministrave. Me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 68, datë 29.01.2025, afati i zbatimit të këtij Plani u shtri deri në fund të vitit 2025.

Në këtë kuadër, Plani i Zbatimit të Garancisë Rinore 2026–2028 synon të thellojë reformat dhe politikat e nisura përmes zbatimit të planit të mëparshëm, si dhe të përcaktojë orientimin strategjik dhe strukturën e përditësuar institucionale të qeverisjes së programit, në funksion të shtrirjes së Garancisë Rinore në nivel kombëtar.

Zbatimi i këtij Plani është i harmonizuar dhe do të mbështetet pjesërisht financiarisht përmes Programit Operacional “BE për Punësimin e të Rinjve”, i ratifikuar me Ligjin nr. 34/2025, *“Për ratifikimin e marrëveshjes së financimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave, dhe Komisionit Evropian, për programin operacional shumëvjeçar për punësimin e të rinjve, në favor të Republikës së Shqipërisë, për periudhën 2024–2027, në kuadër të Instrumentit të Asistencës së Paraanëtarësimit (IPA III)”*. Ky Program Operacional, i financuar nga IPA III, përbën një instrument me bashkëfinancim nga pala shqiptare, si angazhim i Qeverisë Shqiptare për zbatimin e këtij programi.

Plani është hartuar mbi bazën e rezultateve, mësimave të nxjerra dhe kapaciteteve të krijuara gjatë fazës pilot të zbatuar në periudhën 2023–2025, fillimisht në bashkitë Tiranë, Shkodër dhe Vlorë, dhe më pas me shtrirje në nivel rajonal.

Objektivat kryesorë të projektaktit janë:

- miratimi i Planit të ri të Garancisë Rinore 2026–2028 si instrument kombëtar i politikave për integrimin e të rinjve në tregun e punës;
- konsolidimi dhe institucionalizimi i mekanizmave të testuar gjatë fazës pilot në rang kombëtar;
- forcimi i shërbimeve të punësimit, orientimit në karrierë dhe përgatitjes për tregun e punës;

- zgjerimi dhe diversifikimi i ofertave për të rinjtë, në përputhje me profilet e ndryshme të të rinjve NEET;
- krijimi i një kuadri të qëndrueshëm monitorimi dhe vlerësimi, në përputhje me rekomandimet e Komitetit të Punësimit të Komisionit Evropian (EMCO).

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Nxitja e punësimit të të rinjve është një nga prioritetet e Qeverisë Shqiptare dhe Skema e Garancisë Rinore është një ndër instrumentet prioritare të politikave për punësimin e të rinjve, e cila ka kaluar fazën e pilotimit gjatë periudhës 2023–2025 dhe do të konsolidohet përmes zgjerimit të reformave dhe shtrirjes kombëtare.

Plani Ekonomik dhe i Investimeve për Ballkanin Perëndimor, publikuar nga Komisioni Evropian (KE) në tetor 2020, propozon zbatimin e skemës së Garancisë Rinore në Ballkanin Perëndimor në 4 faza gjatë periudhës 2021-2027.

Projektakti është plotësisht në përputhje me Strategjinë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive 2023- 2030, përkatësisht me qëllimin e parë të politikës të dokumentit strategjik “*Ndërmjetësim më Gjithëpërfshirës i Punësimit*” dhe i përgjigjet masës prioritare 2.1.2. “*Tranzicion i mbështetur dhe gjithëpërfshirës nga shkolla në punë për të rinjtë NEET nëpërmjet zbatimit të skemës së Garancisë Rinore*”.

Gjithashtu, skema e Garancisë Rinore përbën një *program prioritar për periudhën 2026-2028, në Dokumentin e Politikave Prioritare të miratuar me VKM 91/2025.*

Projektakti vjen edhe në kuadër të marrëveshjes financiare kuadër të partneritetit, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit Evropian, për zbatimin e asistencës financiare të Bashkimit Evropian për Republikën e Shqipërisë në kuadër të Instrumentit për Asistencën e Paraanëtarësimit (IPA III), ratifikuar me ligjin nr. 65/2022, dhe të nenit 10, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 540 datë 20.09.2023 “*Për përcaktimin e funksioneve, përgjegjësi dhe*

marrëdhënieve ndërmjet autoriteteve e strukturave për menaxhimin indirekt të asistencës financiare të Bashkimit Evropian nën Instrumentin për Asistencën e Paraanëtarësimit 2021-2027 (IPA III) për zbatimin e Programit Operacional “BE për Punësimin e të Rinjve”.

Projektakti është gjithashtu i harmonizuar dhe zbatohet në kuadër të Programit Operacional “BE për Punësimin e të Rinjve”, i ratifikuar me Ligjin nr. 34/2025, *“Për ratifikimin e marrëveshjes së financimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave, dhe Komisionit Evropian, për programin operacional shumëvjeçar për punësimin e të rinjve, në favor të Republikës së Shqipërisë, për periudhën 2024–2027, në kuadër të Instrumentit të Asistencës së Paraanëtarësimit (IPA III)”.*

Projektakti gjithashtu është në përputhje dhe synon drejtpërdrejt përmbushjen e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm të OKB-së, në veçanti të Qëllimit 8: *“Punë e denjë dhe rritje ekonomike”*, si dhe lidhet në mënyrë specifike me Objektivin 8.6: *“Ulja ndjeshëm e përqindjes së të rinjve që nuk janë në punësim, arsim ose formim profesional (NEET) deri në vitin 2030”.*

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Zbatimi pilot i Garancisë Rinore gjatë periudhës 2023–2025 ka krijuar bazën e nevojshme për hartimin e Planit të ri të Zbatimit 2026–2028. Pilotimi mundësoi nisjen e zbatimit të reformave dhe masave për pilotimin e Garancisë Rinore si edhe testimin në terren të mekanizmave të qeverisjes, shërbimeve dhe partneriteteve lokale, si dhe identifikimin e sfidave kryesore që kërkojnë adresim në fazën e shtrirjes kombëtare.

Përvoja e fazës pilot evidentoi vështirësi në identifikimin dhe kontaktimin e të rinjve NEET jashtë regjistrave formalë institucionalë, duke nxjerrë në pah nevojën për mekanizma ndërinstitutionalë dhe për rrjete funksionale të partnerëve vendor. Këto rrjete përfshijnë, përmes mekanizmave të bashkëpunimit të strukturuar, institucionet e punësimit, arsimin, mbështetjes sociale dhe politikave rinore, si dhe organizatat e shoqërisë civile, organizatat rinore dhe partnerët socialë.

Gjithashtu, u konstatua se një pjesë e konsiderueshme e të rinjve NEET, veçanërisht ata nga grupet vulnerabël, kërkojnë shërbime të personalizuar dhe menaxhim më intensiv të rasteve.

Pilotimi tregoi gjithashtu rëndësinë e forcimit të lidhjes midis ofertave të punësimit, arsimit dhe formimit profesional me nevojat e tregut të punës, përmes përfshirjes aktive të punëdhënësve dhe zhvillimit të modeleve të praktikave profesionale dhe formimit dual.

Miratimi i Planit të Garancisë Rinore 2026–2028 synon të adresojë këto sfida përmes një qasjeje të strukturuar dhe gjithëpërfshirëse, të bazuar në katër faza: hartëzimi, kontaktimi, përgatitja dhe oferta.

Efektet e pritshme nga zbatimi i projektaktit përfshijnë:

- Rritjen e pjesëmarrjes së të rinjve NEET në tregun e punës, arsim dhe formim profesional;
- Përmirësimin e cilësisë dhe përshtatshmërisë së ofertave me nevojat e tregut të punës;
- Forcimin e rolit të pushtetit vendor dhe partnerëve lokalë përmes Rrjeteve të Partneritetit Vendor;
- Rritjen e transparencës dhe llogaridhënies përmes një sistemi të konsoliduar monitorimi dhe vlerësimi.

Në plan janë vendosur indikatorë deri në vitin 2028.

Gjithashtu, në plan është detajuar buxheti i planifikuar për çdo masë, në bashkëpunim dhe me kontributin e donatorëve. Çdo masë do të realizohet nga mbështetja e parashikuar në PBA, si dhe në projektet e donatorëve, që janë duke u zbatuar, si dhe projektet e miratuara që do të fillojnë të zbatohen.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Projektvendimi është në përputhje të plotë me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe legjislacionin vendas. Projektvendimi mbështetet në nenin 100 të Kushtetutës, në pikën 4 të nenit 11 të ligjit nr. 15/2019, “Për nxitjen e

punësimit” dhe është në përputhje me Ligjin nr. 9000, datë 30.01.2003 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave” dhe Ligjin 90/2012, datë 27.09.2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, ligjin nr. 65/2022 “Për Ratifikimin e Marrëveshjes Financiare kuadër të Partneritetit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, dhe Komisionit Evropian për rregullat specifike të zbatimit të Asistencës Financiare të BE-së për Republikën e Shqipërisë në kuadër të instrumentit për asistencën e paraanëtarësimit (IPA III)”, Ligjin nr. 34/2025, “Për ratifikimin e marrëveshjes së financimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit Evropian, për programin operacional shumëvjeçar për punësimin e të rinjve, në favor të Republikës së Shqipërisë, për periudhën 2024–2027, në kuadër të Instrumentit të Asistencës së Paraanëtarësimit (IPA III)” si dhe Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 540 datë 20.09.2023 “Për përcaktimin e funksioneve, përgjegjësi dhe marrëdhënieve ndërmjet autoriteteve e strukturave për menaxhimin indirekt të asistencës financiare të Bashkimit Evropian nën Instrumentin për Asistencën e Paraanëtarësimit 2021-2027 (IPA III) për zbatimin e Programit Operacional “BE për Punësimin e të Rinjve”.

Ky projektvendim u gjenerua në sistemin e mbivendosjes ligjore dhe, pas kërkit, rezulton se nuk ka mbivendosje ligjore.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS COMMUNAUTAIRE (PËR PROJEKTAKET NORMATIVE)

Projektakti synon përafrim me legjislacionin e Bashkimit Evropian, përkatësisht me Komunikatën e Komisionit drejtuar Parlamentit Evropian, Këshillit, Komitetit Ekonomik dhe Social Evropian dhe Komitetit të Rajoneve - Mbështetja për Punësimin e të Rinjve: "Një Urë Drejt Punësimit për Gjeneratën e Re", 1 korrik 2020, COM/2020/276 final.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Projektvendimi ka si objekt miratimin e Planit të ri të Zbatimit të Garancisë Rinore

për periudhën 2026–2028, i cili zëvendëson Planin e miratuar në vitin 2023 dhe përcakton kuadrin strategjik, politik, institucional dhe operacional për konsolidimin dhe zgjerimin e masave dhe reformave në kuadër të Garancisë Rinore dhe shtrirjen e plotë të programit në nivel kombëtar.

Plani 2026–2028 bazohet në analizën e zhvillimeve socio-ekonomike, në përditësimin e profilit të të rinjve NEET sipas të dhënave nga INSTAT dhe në vlerësimin e rezultateve dhe sfidave të fazës pilot 2023–2025. Ky plan vjen në vijim të Planit të kaluar duke rishikuar reformat dhe masat e përfshira në bazë të zhvillimeve të fundit, mësimet të nxjerra nga pilotimi dhe pritshmëritë deri në vitin 2028.

Projektakti përcakton objektivat strategjike të Planit, grupin përfitues – të rinjtë e moshës 15–29 vjeç që nuk janë në punësim, arsim apo formim profesional (NEET) – si dhe parimet themelore të ndërhyrjes, përfshirë qasjen e individualizuar, koordinimin ndërinstitucional, partneritetin me pushtetin vendor dhe shoqërinë civile, si dhe orientimin drejt rezultateve të matshme.

Në përputhje me udhëzimet e Komisionit Evropian për kornizën e Garancisë Rinore, Plani i ri i Zbatimit strukturohet në katër faza kryesore ndërhyrjeje: hartëzimi, kontaktimi, përgatitja dhe oferta:

1. **Faza e Hartëzimit** – Kjo fazë e zbatimit të Planit të Garancisë Rinore përqendrohet në forcimin e sistemeve të mbledhjes, përpunimit dhe analizës së të dhënave, me qëllim përmirësimin e profilizimit statistikor të popullsisë NEET në Shqipëri, parandalimin e braktisjes së hershme të shkollës dhe rritjen e kapaciteteve për analizën e tendencave të tregut të punës. Gjatë fazës së parë të zbatimit u evidentua progres në profilizimin e NEET-ve dhe zgjerimin e Sistemit të Paralajmërimit të Hershëm për parandalimin e braktisjes shkollore në sistemin arsimor të përgjithshëm dhe profesional, ndërkohë që mbetet e nevojshme konsolidimi i mëtejshëm i instrumenteve metodologjike, institucionalizimi i analizave periodike dhe forcimi i lidhjes funksionale ndërmjet ofertës së formimit profesional, shërbimeve të këshillimit për punësim dhe nevojave të tregut të punës.
2. **Faza e Kontaktimit** – Kjo fazë përqendrohet në konsolidimin dhe zgjerimin e qasjes për kontaktimin përmes funksionalizimit të partneriteteve vendore dhe forcimit të mekanizmave të identifikimit,

aktivizimit dhe mbështetjes së të rinjve NEET. Gjatë fazës së parë u shënuan përparime të rëndësishme në zhvillimin dhe pilotimin e Modelit të Kontaktimit dhe strukturës së tij të qeverisjes, ndërkohë që mbetet e nevojshme përshtatja sipas mësimave të nxjerra, shtrirja kombëtare dhe forcimi i qëndrueshmërisë së mekanizmave të financimit për mbështetjen e këtyre ndërhyrjeve.

3. **Faza e Përgatitjes** - Kjo fazë përqendrohet në diversifikimin dhe konsolidimin e shërbimeve përgatitore, si kusht thelbësor për rritjen e efektivitetit të Garancisë Rinore. Heterogjeniteti i profileve të të rinjve NEET kërkon rritjen e individualizimit të ndërhyrjeve, veçanërisht në fazën përgatitore, ku adresohen pengesat individuale dhe krijohen kushtet për përgatitjen e të rinjve, e veçanërisht atyre nga grupet vulnerabël, për një oferte brenda skemës së Garancisë Rinore. Gjatë ciklit të parë të zbatimit u shënuan përparime në zhvillimin e një portofoli shërbimesh që mbështesin qasjen për menaxhimin e integruar të rasteve, ndërkohë që mbetet prioritet zgjerimi, testimi dhe konsolidimi i këtij portofoli përmes Rrjeteve të Partneritetit Vendor në ciklin vijues të zbatimit.
4. **Faza e Ofertës** – Plani 2023-2025 mundësoi progres të rëndësishëm në zgjerimin dhe diversifikimin e portofolit të ofertave, veçanërisht në fushat e arsimit e formimit profesional dhe praktikave në vendin e punës, përfshirë praktikat profesionale dhe formimin nëpërmjet punës. Në këtë kuadër, plani 2026–2028 do të fokusohet në konsolidimin dhe përmirësimin e portofolit ekzistues të ofertave, si edhe në zgjerimin e tij të mëtejshëm, duke pasur parasysh kompleksitetin dhe kërkesat e larta në burime dhe kapacitete që lidhen me disa prej tyre. Njëkohësisht, do të forcohet koordinimi ndërmjet fazës përgatitore dhe asaj të ofertave, për të garantuar që ndërhyrjet përgatitore të krijojnë kushtet e nevojshme për përshtatjen optimale të ofertave me profilet individuale të të rinjve NEET. Plani 2026–2028 vendos gjithashtu si objektiv rritjen e përfshirjes së sektorit privat në zbatimin e ofertave të Garancisë Rinore, përmes forcimit të mekanizmave të bashkëpunimit dhe angazhimit të tyre në proceset e të nxënit dhe krijimit të mundësive të punësimit.

Projektakti përcakton gjithashtu modelin e qeverisjes së Garancisë Rinore, duke saktësuar rolet dhe përgjegjësitë e institucioneve qendrore dhe vendore, si dhe parashikon funksionimin e një kuadri të konsoliduar monitorimi, raportimi dhe vlerësimi, në përputhje me rekomandimet e Komitetit të Punësimit të Komisionit

Evropian (EMCO).

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E AKTIT

Institucionet që ngarkohen për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi janë Ministria Ekonomisë dhe Inovacionit, Ministria e Arsimit, Ministria e Turizmit, Kulturës dhe Sportit, Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqënies Sociale, Ministri i Shtetit për Pushtetin Vendor, Ministria e Financave, Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive, Agjencia Kombëtare për Arsimin, Formimin Profesional dhe Kualifikimet, Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore, Agjencia Kombëtare e Rinisë, Shërbimi Social Shtetëror, Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit, Departamenti i Administratës Publike, INSTAT, Bashkitë.

VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Projektvendimi “Plani i Zbatimit të Garancisë Rinore 2026-2028” u hartua nga Grupi Teknik i Punës për Garancinë Rinore, ngritur me Urdhrin e Kryeministrit nr. 28, datë 24.02.2022 *“Për ngritjen e grupit ndërinstitutional të punës dhe të grupit teknik të punës, për hartimin, zbatimin dhe monitorimin e planit kombëtar të Garancisë Rinore, si dhe caktimin e koordinatorit kombëtar”*, ndryshuar në 20.05.2024, në bashkëpunim me strukturat e Drejtorisë së Përgjithshme të Punësimit, Aftësimit dhe Sigurimeve Shoqërore në Ministrinë e Ekonomisë dhe Inovacionit, si dhe me Agjencinë Kombëtare për Punësim dhe Aftësi.

Hartimi i planit u mbështet përmes asistencës teknike e projektit “BE për Rininë”, financuar nga Bashkimi Evropian dhe zbatuar nga UNDP dhe UNICEF në Shqipëri.

Hartimi i Planit është mbështetur në një proces të gjerë konsultimi me aktorë të ndryshëm institucionalë, partnerë dhe përfaqësues të shoqërisë civile dhe partnerëve socialë, si më poshtë:

1. Analiza e profilit të të rinjve NEET, në bashkëpunim me INSTAT.

2. Analiza e mësimave të nxjerrë nga zbatimi pilot gjatë periudhës 2023-2025.
3. Konsultim me Grupin Teknik të Punës për Garancinë Rinore (21 tetor 2025)
4. Konsultim me institucionet në nivel qendror, vendor dhe organizata të shoqërisë civile në bashkëpunim me Fondacionin European të Trajnimeve/ETF (11 dhe 12 nëntor 2025)
5. Konsultim me partnerët ndërkombëtare dhe organizata të shoqërisë civile në Grupin Tematik për Punësimin, Aftësitë dhe Punën e Denjë, në kuadër të Grupit të Menaxhimit të Politikave të Integruara (27 nëntor 2025)
6. Konsultim me Grupin Teknik të Punës për Garancinë Rinore dhe organizata të shoqërisë civile (23 dhjetor 2025).

Projektvendimi dërgohet për mendim në Ministrinë e Drejtësisë, Ministrinë e Financave, Ministrinë e Arsimit, Ministrinë e Turizmit, Kulturës dhe Sportit, Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mirëqënies Sociale, Ministrin e Shtetit për Pushtetin Vendor, Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Agjencisë Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit, INSTAT-it, si dhe Këshillit Konsultativ mes Qeverisjes Qendrore dhe Vetëqeverisjes Vendore. Projektvendimi dërgohet për dijeni në Agjencinë Shtetërore të Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Financimi do të bëhet nga Buxheti i Shtetit për Ministrinë e Ekonomisë dhe Inovacionit sipas parashikimeve buxhetore afatmesme dhe afatgjata në PBA 2026-2028, në Programin Buxhetor 10550 “Tregu i Punës”.

MINISTËR

Delina Ibrahimaj